



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr.2991/2Prot.

Tiranë më 21.06.2018

VENDIM

Nr. 23, datë 21.06.2018

“Për hapjen e programit të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Psikologji Ligjore”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 25, pika 7; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 75, pika 6; Udhëzimin Nr.31, datë 29.12.2017, Kreu I, pika 2; Kreu II, pika 1 dhe Kreu IX pika 1; Statutin e Universitetit të Tiranës, neni 19, pika 1; neni 20; si dhe në propozimin e Fakultetit të Shkencave Sociale me shkresën Nr.167/5 Prot., datë 14.06.2018, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 21.06.2018,

VENDOSI:

1. Të miratojë propozimin për hapjen programit të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional” në “Psikologji Ligjore” me 60 kredite, në Departamentin e Pedagogjisë dhe të Psikologjisë, të Fakultetit të Shkencave Sociale, të UT-së.
2. Të përcillet në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë propozimi dhe dokumentacioni i plotë për vijimin e procedurave miratuese.

KRYETARI

PROF.DR. MYNYR KONI